



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-29972 dt. 22.06.2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **29.06.2023** (E enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS


Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 26.05.2023 dhe vazhdimi i mbledhjes me dt. 31.05.2023
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor.
3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.
4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.
5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro
7. Të ndryshme.

Drenas, 22.06.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		22.06 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	060/01	29972	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 22.06.2023, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota **“Për”**, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua rendi i ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.05.2023.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota **“Për”**, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua procesverbali i KPF-së.

2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor.

Pas diskutime vërejtje dhe sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota **“Për”**, 1 kundër, 1 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.

Pas diskutime vërejtje dhe sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 04 vota **“Për”**, 1 kundër, 2 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota **“Për”**, kundër nuk pati, 1 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota **“Për”**, kundër nuk pati, 1 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro
- Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “**Për**”, kundër nuk pati, 1 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.
7. Të ndryshme.
- Nuk pati diskutime kërkesa apo sugjerime.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:10 min .





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr. 030/L-28130 dt. 13/06/2023

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E
QYTETIT-GLLOGOC

Neni 1

Miratohet vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit- Glllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej $S=110.00$ Ha.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

RL

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glllogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022, është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane.

Me Vendimin 02-Nr.400/01-14932 datë 28.03.2023 të kuvendit të komunës, është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc ka zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti së bashku me përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glogocit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 400-28321 dt. 14.06 2023

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-2789, të dt. 12.06.2023, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2023.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Presonave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin Nr. 01-020/04-24052 e dt. 22.05.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-22083, të dt. 10.05.2023, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2023.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (dy) OJQ: “HANDIKOS” dhe “BLIRI” .

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të dy organizatave aplikuese, të cilat vazhdojnë të jenë funksionale, mirëpo OJQ “Bliri” nuk i ka përmbushur kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë komisioni me vendim përcakton si aplikant i kualifikuar për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS” Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 40061-28513 dt. 15.06.2023

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 , 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të palës, Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.5.2023, të aprovojë këtë:

POPOZIMVENDIM

**Për miratimin e Kërkesës, Nr. 01-070/01-26071, dt. 1.6.2023, për ndihmë
financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer, në shumën totale prej
3,000.00 euro**

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022, propozohet miratimi i Kërkesës Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Propozim Vendimi do të paguhën nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760, të parapara me buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Buxhetin për vitin 2023, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë në emër të **Milaim Bazaj, NLB, nr. i kontos: XK05 17-01-0186045108.77.**

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit .



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me datë 1.6.2023, pranë Zyrës së Kryetarit është adresuar kërkesa me numër Nr. 01-070/01-26071, dt. 1.6.2023, përmes së cilës pala Milaim Bazaj, ka adresuar nevojën e tij për mbështetje financiare për trajtimin urgjent mjekësor të motrës së tij, Nazmije Bazaj, me kancer, sëmundje të cilën e ka dëshmuar edhe me dokumente mjekësore. Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët rezidentë të Komunës së Drenasit për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti,

proponohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta, Kuvendi i Komunës të aprovojë kërkesën e qytetarit të komunës së Drenasit z. Milaim Bazaj për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro si rast i cili i plotëson kriteret për subvencionim emergjent për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale dhe njëkohësisht si rast i cili kërkon veprim të menjëhershëm nga ana e jonë duke i mundësuar palës së lartëcekur vazhdimin e trajtimit të nevojshëm mjekësor për motrën e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-28510 dt. 15.06.2023

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 , 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të palës, Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____, të aprovojë këtë:

P O P O Z I M V E N D I M

**Për miratimin e Kërkesës, Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, për ndihmë
financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – OU Nicrophthalma, në shumën
totale prej 3,000.00 euro**

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022, propozohet miratimi i Kërkesës Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – **OU Nicrophthalma**, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Propozim Vendimi do të paguhën nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760, të parapara me buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Buxhetin për vitin 2023, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë në emër të **Bedri Bazaj, ID 1249036052, në Raifeisen Bank, nr. i kontos: 1501070002530610.**

(Signature)

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me datë 13.6.2023, pranë Zyrës së Kryetarit është adresuar kërkesa me numër Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.6.2023, përmes së cilës pala Bedri Bazaj, ka adresuar nevojën e tij për mbështetje financiare për trajtimin urgjent mjekësor të fëmijës së tij, Olta Bedri Bazaj, me sëmundjen **OU Nicrophthalma**, të cilën e ka dëshmuar edhe me dokumente mjekësore.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët rezidentë të Komunës së Drenasit për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti,

propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta, Kuvendi i Komunës të aprovojë kërkesën e qytetarit të komunës së Drenasit z. Bedri Bazaj për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – **OU Nicrophthalma**, në shumën totale prej 3,000.00 euro si rast i cili i plotëson kriteret për subvencionim emergjent për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale dhe njëkohësisht si rast i cili kërkon veprim të menjëhershëm nga ana e jonë duke i mundësuar palës së lartëcekur vazhdimin e trajtimit të nevojshëm mjekësor për fëmijën e tij.



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	100101	29121	

KOMUNA E DRENASIT
LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2024-2026



01-400101 Zgjerimi									
Prog	Emri i Projektit	10 - BKK 2024	21 - THV 2024	Financimi Humarrja	Totali 2024	Vlerësuar për 2025	Vlerësuar për 2026	Totali 2024-2026	Financimi Jashtëm
611180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia									
Infrastrukturë Rrugore									
451	Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve Drenas, Komoran, Terstenik Aritat BaicDobroshec	-	50,000.00	0	50,000.00	30,000.00	30,000.00	110,000.00	0
451	Zgjerimi kamerave në Drenas dhe Komoran	-	5,000.00	0	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00	0
451	Regullimi dhe mirmbajtja trotuarve dhe parkingleve Drenas dhe Komoran	-	15,000.00	0	15,000.00	15,000.00	15,000.00	45,000.00	0
451	Riparimi dhe zgjerimi i vendjeve për autobus dhe mblidhje Shulice Verboc Terstenik Aritat	-	20,000.00	0	20,000.00	20,000.00	10,000.00	50,000.00	0
SHPMCE-Infrastrukturë Rrugore		-	90,000.00	0	90,000.00	70,000.00	60,000.00	220,000.00	0
Drejtoria për Infrastrukturë Publike									
Infrastrukturë Publike									

451	Regullimi i shtatit të lumit Drenica dhe Verbica	-	25,000.00	-	25,000.00	20,000.00	20,000.00	65,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë	150,000.00	150,000.00	-	300,000.00	400,000.00	200,000.00	900,000.00	0
451	Ndërtimi i rrugës bregut Qyqavices	-	5,000.00	-	5,000.00	60,000.00	60,000.00	125,000.00	0
451	Ndërtimi i parkut dhe shigjerve për këmbësor, biçiklist në parkun e Kamenicës	150,000.00	100,000.00	-	250,000.00	-	-	250,000.00	0
451	Drenas	400,000.00	-	-	400,000.00	300,000.00	300,000.00	1,000,000.00	0
451	Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshec	200,000.00	150,000.00	-	350,000.00	330,000.00	330,000.00	1,010,000.00	0
451	Regullimi trotuareve dhe ndërtimi publik Drenas, Komoran, Aritat, Terstenik, Dobroshec dhe Baic	166,117.00	83,883.00	-	250,000.00	300,000.00	500,000.00	1,050,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës dhe kubizim në Drenas I, II, III dhe IV	700,000.00	-	-	700,000.00	400,000.00	279,000.00	1,100,000.00	0
451	Zgjerimi dhe ndërtimi i shtetit "Fehmi e Xheva Lladrovci" Drenas	100,000.00	-	-	100,000.00	170,000.00	279,000.00	549,000.00	0
451	Ndërtimi i rrugëve në Komoran I, II, III dhe IV	100,000.00	-	-	100,000.00	80,000.00	149,000.00	329,000.00	0
451	Terstenik, Dobroshec, Baic dhe Qikato e Vjetër	560,000.00	-	-	560,000.00	700,000.00	703,455.00	1,963,455.00	0
451	Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas	500,000.00	-	-	500,000.00	450,000.00	189,000.00	1,139,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasselle Godanc	150,000.00	-	-	150,000.00	190,000.00	280,000.00	620,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I, II dhe Gllobar	80,000.00	-	-	80,000.00	159,000.00	100,000.00	339,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I, II dhe Gllobar	120,000.00	-	-	120,000.00	180,000.00	100,000.00	400,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri Epërme, Terdevc	80,000.00	-	-	80,000.00	159,000.00	100,000.00	339,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec, Qikato e Vjetër	120,000.00	-	-	120,000.00	170,000.00	212,545.00	502,545.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Baicë, Kralikovë, Damanek, Shtrubulovë	80,000.00	-	-	80,000.00	150,000.00	150,000.00	380,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Njokc, Kizharekë	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	140,000.00	320,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradic dhe Likoshan	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	150,000.00	330,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Aritat, Negroc, Gjegjice si dhe Bylyq	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	140,000.00	320,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushice e Epërme dhe Ulet	100,000.00	-	-	100,000.00	118,795.00	150,000.00	348,795.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Shulic Verboc dhe Poluzhe	80,000.00	-	-	80,000.00	120,000.00	140,000.00	360,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës fshat Llapushnik, Polek-Vukoc	100,000.00	-	-	100,000.00	120,000.00	219,000.00	419,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës fshat Llapushnik, Polek-Vukoc	80,000.00	-	-	80,000.00	120,000.00	140,000.00	360,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës fshat Llapushnik, Polek-Vukoc	200,000.00	-	-	200,000.00	341,055.00	500,000.00	1,041,055.00	0
451	Ndërkapaciteti të ujësve në Drenas	30,000.00	-	-	30,000.00	79,395.00	119,000.00	228,395.00	0
451	Hapja e Kanaleve Kulluese për gjatë rrugëve Drenas, Komoran, Aritat, Terstenik, Dobroshec dhe Baic	25,000.00	-	-	25,000.00	80,000.00	119,000.00	224,000.00	0
451	Hapja dhe ndërtimi i rrugëve fushore	53,656.00	-	-	53,656.00	467,769.00	700,000.00	1,221,425.00	0
451	Rrethoia e QMF-AMF	50,000.00	-	-	50,000.00	-	-	50,000.00	0
451	Renovimi - AMF Dobroshec	30,000.00	-	-	30,000.00	-	-	30,000.00	0
451	Ndërtimi i shtëpise për komunitete- shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara	230,000.00	-	-	230,000.00	230,000.00	200,000.00	660,000.00	0

451	Objekte sportive	100,000.00		100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00	300,000.00	
451	Fusha Sportive dhe rekracion	190,000.00		190,000.00		200,000.00	200,000.00	590,000.00		
451	Ndërtimi i parkingjeve ne shkolla	40,000.00		40,000.00		40,000.00	40,000.00	120,000.00		
451	Ndërtimi i fushave te jashtme sportive dhe rrethojave	50,000.00		50,000.00		30,000.00	30,000.00	110,000.00		
451	Ndërtimi i nryeve sanitare si aneks i ri ne SHFMU" Rilindja"	30,000.00		30,000.00		213,017.50	100,000.00	338,017.50		
451	Ndërtimi i shkollës së re Rasin Kicina në Drenas	25,000.00		25,000.00		15,000.00	150,000.00	180,000.00		
451	Instalimi i nxemjleve qendrore	15,000.00		15,000.00		43,000.00	36,591.60	122,591.60		
451	Gjelbrimi i hapësirave publike mbjellja e druve dekorativ shume vjeçare	43,000.00		43,000.00						
Totali - Infrastrukturë Publike		5,367,773.00	513,883.00	5,881,656.00	6,816,031.50	7,046,591.60	19,744,279.10	0		
611660 - Planifikimi Urban dhe Mjedis		5,367,773.00	513,883.00	5,881,656.00	6,816,031.50	7,046,591.60	19,744,279.10	0		

611660 - Planifikimi Urban dhe Mjedis		Planifikim Urban dhe Inspektion								
620	Mirëmbajtja e sistemit te adresave, vendosja e tabelave dhe numrave	5,000.00	-	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00	0		
620	Rregullimi i kendit te lojtrave per fëmijë	10,000.00	-	10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00	0		
Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedis		15,000.00		15,000.00	15,000.00	15,000.00	45,000.00	0		

611730 - Shëndetësia dhe mirëgjënia sociale										
Sherbime shëndetësore primare										
721	Pajisje speciale mjeksore mbi 1000€	30,822.00		30,822.00	294,133.50	355,991.40	680,946.90			
721	Generator	20,000.00		20,000.00	0	0	20,000.00			
721	Veçura per vizita shpieake	40,000.00		40,000.00			40,000.00			
721	Veçura zyrtare	60,000.00		60,000.00						
Totali - Shëndetësia dhe mirëgjënia sociale		150,822.00		150,822.00	294,133.50	355,991.40	800,946.90	0		

611850 - Kulturë, Rini, Sport		Sherbimet Kulturore								
820	Renovimi i objekteve sportive	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	60,000.00			
820	Blerja e librave	5,000.00	-	5,000.00	5,000.00	4,000.00	14,000.00	0		
Totali - Kulturë, Rini, Sport		25,000.00		25,000.00	25,000.00	24,000.00	74,000.00			

611920 - Arsium dhe Shkencë		Administratë - Glllogoc								
980	Digitalizimi i shkollave- Softwer (platforma digjitale) dhe pajisje perçeljele	60,000.00		60,000.00	60,000.00	10,000.00	130,000.00			
980	Kabinete ne shkolla	40,000.00	-	40,000.00	-	-	80,000.00	0		
980	Kendi i lojtrave dhe rekracion ne shkolla	40,000.00		40,000.00	40,000.00	-	-			
980	Furnizim me pajisje te TIK-ut	70,000.00	-	70,000.00	70,000.00	70,000.00	210,000.00	0		
Totali - Arsium dhe Shkencë		210,000.00		210,000.00	170,000.00	80,000.00	460,000.00	0		
Totali		5,367,773.00	1,004,705.00	6,372,478.00	7,390,165.00	7,581,583.00	21,344,226.00	0		

Glllogoc, me 09.06.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		19/10/2028	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400101	29121	

Buxhetimi gjinor 2024
Tabela 1: Numri I punëtorve

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2021	1325	567	758	3,896,635	4,652,366
2022	1325	604	721	3,945,460	4,754,540
2023	1327	603	724	3,953,280	4,746,720
Planifikimi për 2024	1368	625	743	4,419,232	5,252,976

Tabela 2: Planifikimi për vitin 2024 Nivelet e pagave
Emri I Institucionit: Komuna e Drenasit

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	243	204	1,442,079	39	275,704
401-600	1010	463	3,273,561	547	3,867,469
600+	115	65	455,152	50	358,243

Tabela 3. Numri I përfituesve të subvencioneve nga komuna, apo edhe të shërbimeve të ofruara nga
Emri I institucionit : Komuna e Drenasit

Viti	Buxheti total i shërbimit/su bvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve e gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxhe ti për burra
2021	270,000	442	131	311	80,872	189,128
2022	370,000	708	310	398	107,820	262,180
2023	420,000	508	172	336	142,212	277,788
Planifikimi për 2024	493,000	445	176	269	196,110	296,890

Kryetari i Komunës



[Handwritten signature]

Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		19/06/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01	29/21	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
KOMUNA DRENAS (GLLOGOC)
Zyra e Kryetarit

DRAFT - KORNIZA
AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
2024 - 2026

Drenas, qershor 2023

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

III. KORNIZA FISKALE

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendencë e të hyrave komunale dhe parashikimet 2024-2026
- 3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2024-2026
- 3.6. Analiza Gjimore

IV. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE

V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB-i), që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i, siguron mekanizmat e nevojshëm për të arritur objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2024/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT-ja) në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP-it).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME 2024-2026 NGA STRATEGJIA ZHILLIMORE KOMUNALE

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, në një sipërfaqe prej: 275.63 km², apo 2.66 për qind e sipërfaqës së territorit të Kosovës. Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Drenasit ka gjithsej 42 vendbanime. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna ka 58,531 banorë të organizuar në 8,992 ekonomi familjare, **ndërsa për vitin 2024 vlerësohet të ketë përaferësisht 65,919 banorë.**

Mbi 2.018 biznese aktive që operojnë brenda territorit të Komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Drenasit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare dhe tjera 53.72% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 28.59% në prodhimtari 17,69%, pjesa tjetër në transport.

Zhvillimi i qendrueshem ekonomik, fokusim në krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm biznesor, modernizimin e infrastrukturës, përkrahjen e vazhdueshme të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Transporti dhe komunikimi, Mjedisi dhe planifikimi hapësinor.

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar për-rreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit. Nga të cilat 5 (pesë) janë të vendosura në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-i) 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve në bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore 2024 (I)+(II), të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qarkoreve të brendshme buxhetore (I) + (II).

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Drenasit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti - llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve binjake prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër (4) prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Drenasit:

1. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE ME MUNDËSI PËR TË GJITHË

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

3. PËRMIRËSIMI I AMBIENTIT TË KOMUNËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. KRIJIMI I QEVERISË KOMUNALE QË OFRON SHËRBIME EFIKASE DHE QË U PËRGJIGJET KËRKESAVE TË QYTETARËVE

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

- ◆ Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyrave komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve.

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2024-2026 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë kryesore ekonomike të shpenzimeve të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve. Alokimi i shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave, si dhe arritje e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara.

III. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e Qeverisë Qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë (Tabela 1:Indikatorët Ekonomik). Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, Konsumi dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2024 - 2026 parashihet një rritje reale vjetore mesatarisht, viti 2024 prej 5.5 % derisa në vitet 2025-2026 prej 5.8% deri 5.9% , vlerësimet në mesin e institucioneve (MFPT, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore dhe FMN-ja).

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të zbutet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve) si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Drenasit në periudhën afatmesme buxhetore 2024-2026 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik

Përshkrimi	2023 (viti e 1)	2024 (viti e 2)	2025 (viti e 3)	2026 (vlerësim)
Indikatorët kryesorë ekonomikë, nivel vendi				
BPV	5.2%	5.5%	5.8%	5.9%
Konsumi	1.4%	4.8%	5.8%	4.6%
Investimet	5.4%	7.7%	7.0%	9.1%
Eksporti	4.2%	6.0%	6.5%	6.5%
Importi	-0.5%	5.9%	6.7%	6.3%
IÇK	5.2%	2.1%	1.8%	1.8%
Deflatori	5.2%	2.5%	2.1%	2.0%
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	64,627	65,919	67,237	68,582
Numri i bizneseve aktive	2,245	2,445	2,645	2,845
Numri i nxënësve	11,897	11,535	11,210	11,100

Burimi i të dhënave: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve- Qeveria e Kosovës, 2024-2026 dhe drejtoratet komunale.

3.2. TË HYRAT KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFAT-MESËM 2024-2026

Të hyrat e Komunës së Drenasit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 2: Buxheti total i komunës në vite , shprehur në € (Euro) :

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali	Projeksioni	Projeksioni provues	
	2023	2024	2025	2026
Spektori i Administratës	9,126,783	10,234,624	10,941,822	11,635,577
Spektori i Arsimit	6,564,735	7,870,632	8,106,940.70	8,349,309
Spektori i Shëndetësisë	2,465,374	2,863,736	3,007,123	3,155,579
Gjithsej të hyrat:	18,156,892	20,968,992	22,055,885.70	23,140,465

Në bazë të planifikimit të bërë në vitin 2023, të hyrat buxhetore për Komunën si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e të hyrave buxhetore për vitin 2024 do të jetë mesatarisht **14.97%** në krahasim me vitin 2023, sipas projeksionit provues (2024-2025) rritja planifikohet të jetë **13.02%**, në krahasim me vitin 2023. Brenda kornizës buxhetore (2024-2026) rritja e të hyrave planifikohet mesatarisht **19.55 %**, krahasuar me vitin aktual. Sipas të dhënave të prezantuar në tabelë, rritja e të hyrave në vitin 2024, kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2024-2026. rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm dhe të Arsimit (Granti Specifik).

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, do të kenë një rritje të lehtë nga viti në vit, po ashtu (vlerësim ky nga niveli qendror). Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat tatimore.

KALKULIMET E TATIMIT NË PRONË:

- *Vlera e patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave
- *Vlera e kalkuluar vjetore*- që duhet të mbliidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e pagesës vjetore*- Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i akumuluar dhe pagesa e pritur e borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

KALKULIMET E TË HYRAVE TJERA:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të komunës janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe ngarkesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumnin e shërbimeve të ofruara nga programet buxhetore.

Tabela 3: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale sipas burimit të financimit dhe kategorive të të hyrave për periudhën 2024-2026, shprehur në € (Euro)

	Komuna: Drenas (Glllogoc)	Grantet dhe THV – 2023	Grantet dhe THV – 2024	Grantet dhe THV – 2025	Grantet dhe THV – 2026
	BURIMET E TË HYRAVE	(këtë vit)	(vitin e 1)	(vitin e 2)	(vitin e 3)
0	GJITHSEJ GRANTET (Fondi10)	16,799,424	19,408,287	20,440,756	21,447,746
	Granti i Përgjithshëm	7,829,315	8,736,919	9,392,692	10,008,858
	Granti Specifik i Arsimit	6,538,735	7,843,632	8,078,940.70	8,321,309
	Granti Specifik i Shëndetësisë	2,431,374	2,827,736	2,969,123	3,117,579
1	Taksa për shfrytëzimin e të mirave publike (shfrytëzimi i infrastrukturës që komuna ofron)	142,000	198,000	200,000	203,000
	Funksionimet e subjekteve ekonomike brenda teritorit të komunës.	142,000	198,000	200,000	203,000
2	Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit	45,000	65,000	70,000	72,000
	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	45,000	65,000	70,000	72,000
3	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	50,000	50,000	52,000	54,000
	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	25,000	25,000	26,000	27,000
	Aktivitetet në teren që kanë të bëjnë me matjen e vendit	25,000	25,000	26,000	27,000
4	Shërbimet e inspektimit të shëndetit dhe sigurisë	25,000	18,000	18,000	23,000
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	14,000	7,000	7,000	12,000
	Inspektimi i ambientit	4,000	4,000	5,000	6,000
	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrëfikësve dhe konstruktimit	7,000	7,000	6,000	5,000
5	Shfrytëzimi i pronës komunale	40,000	25,000	29,746	35,957
	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	40,000	25,000	29,746	35,957
6	Pagesat në lidhje me automjetet	100,000	124,000	125,500	127,000

	Parkimi në parkingun publik i pajisur me garazhim apo hapësira tjera	9,000	2,000	2,500	3,000
	Regjistrimi i automjeteve	91,000	122,000	123,000	124,000
7	Certifikatat dhe dok. zyrtare	60,000	60,000	61,000	62,000
	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj, martesës,shkurorizimit	55,000	55,000	56,000	57,000
	Të tjera, shërbime	5,000	5,000	5,000	5,000
8	Tatimi në Pronë (objekte & tokë)	748,782	937,615	960,884	1,005,762
	Pagesat për objekte	518,492	774,863	794,642	832,788
	Pagesat për tokë	230,290	162,752	166,242	172,974
9	Të Hyrat tjera	83,686	20,090	32,000	44,000
	Pagesat tjera	83,686	20,090	32,000	44,000
I-A.	Nëntotali I-A , Të Hyrat direkte (tatimore dhe jo tatimore) (21)	1,294,468	1,497,705	1,549,130	1,626,719
	Denimet në komunikacion, të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	0	0	0	0
	Gjoha të gjykatave	0	0	0	0
I - B.	Nëntotali I-B , Të Hyrat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	0	0	0	0
I	Totali i Administratës Komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	1,152,986	1,497,705	1,549,130	1,626,719
	TË HYRAT NGA ARSIMI	26,000	27,000	28,000	28,000
	Qerdhet- (bashk-pagesat)	26,000	27,000	28,000	28,000
II	Totali – Arsimi	26,000	27,000	28,000	28,000
	TË HYURAT NGA SHËNDETËSIA	34,000	36,000	38,000	38,000
1	Shëndetësia –(participimi)	34,000	36,000	38,000	38,000
III.	Totali - Shëndetësia	34,000	36,000	38,000	38,000
Kodi 21	TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNË S (I+II+III) Fondi 21:	1,357,468	1,560,705	1,615,130	1,692,719
	TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE (10+21)	18,156,892	20,968,992	22,055,885.70	23,140,465

Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2023-2025) do të përbëjnë afërsisht **92.56%** të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e granteve në buxhet ka qenë përafërsisht **92.31%**. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **7.44%**, prej tyre të hyrat tatimore me **60.08%**; ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më **39.92%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të

financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Maj/2023. Planifikimi i buxhetit komunal ndër vite pritet të ketë një rritje mesatare prej 5.46%.

3.2.1. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët

Vlera totale e projekteve më bashkëfinancim me Ministritë e Linjës dhe Donatorët tjerë për vitet 2024-2026 është në shumë prej:4,170,000 Euro. Nga kjo, vlera investuese për projekte do të ketë rritje prej:2,600,000Euro, mjete këto që do të sigurohen nga palët e treta.

Tabela 4: Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët.

Emri i projektit	Partneri bashkëfinancues	Gjithsej euro:		Prokurim i nga:	Komente	Opsionale	
		Komuna	Bashkëfinancuesi			% përfitues meshkuj	% përfitues femra
Ndërtimi i Stadionit (Faza e dytë)	MKRS	70,000	100,000	Komuna		50.5	49.5
Ndërtimi i Kolektorve për grumbullimin e ujrave të zeza	MMPH	500,000	500,000				
Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Xhevat Demaku Drenas	MMPHI	500,000	700,000	Komuna		50.5	49.5
Ndërtimi i parkut të pishat Komoran	MZHR	200,000	300,000	Komuna		50.5	49.5
Ndërtimi i rrugës kurrizit të Qyqavicës	MZHR	300,000	1,000,000	Komuna		50.5	49.5
Total financimi		1,570,000	2,600,000			50.5	49.5

3.2.2. Politikat e reja

Komuna e Drenasit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2024-2026, sugjerimet e Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë për qind (10.00%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë Qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2024 - 2026 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunitetin e Drenasit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference-negative që do të shkaktoje ulja e nivelit të Grantit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së Grantit të Arsimit për Komunën, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë Grantin e Arsimit, duhet pasqyruar se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komunën nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike. Në tri vitet e ardhshme komuna kërkohet t'i trajtojë pagesat në lidhje me obligimet që rrjedhin me kontratat kolektive, pagesa këto të cilat do ta prishin ekuilibrin e buxhetit komunal, sidomos në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve.

Së treti, Komunën ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e komunës. Tutje, komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmen ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike. Në këtë fazë Komunës i mungojnë të dhënat lidhur me kufirin në paga, në mungesë të akteve nën-ligjore për përcaktimin e koeficienteve.

Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunë, është edhe politika që do të zgjedhjet nga viti 2023 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komunën e Drenasit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin e kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërim nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave për sigurimin e grantit specifik për këtë fushë.

Së pesti, Komunën ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qendrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi që këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të Hyrat Vetanake Komunale. Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal. Tutje, Komunën e Drenasit, është ballafaquar gjatë dy viteve të fundit me rënien e dukshme të të hyrave nga ngarkesa e bizneseve si rezultat i lirimt të bizneseve nga ky obligim që po e bëjnë disa komuna të Kosovës. Qeveria Komunale në 3 vitet e ardhshme planifikon të analizojë trendin e të hyrave nga kjo fushë, rrjedhimisht në bazë të analizës të propozojë modifikim të vendimit të Asamblesë Komunale, eventualisht propozim të masave shtesë drejt evitimit të çështjeve të dala drejt administrimit të këtij vendimi të marrë nga Asambleja Komunale.

3.3.SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2024-2026

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikua përmes Qarkores Buxhetore MFT. 2024/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2024, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Drenasit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve buxhetore:

Tabelat e kërkesave fillestare buxhetore (2024-2026) sipas programeve-nën programeve buxhetore dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve, shprehur në € (Euro) :

Tabela 5: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2024

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.K omunale	Subvenci one	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Zyra kryetarit	172,404	100,622		8,000		281,026
D.Administratës	246,193	156,700				402,893
D.Inspekcionit	75,919	64,500				140,419
Zyra e Kuvendit	264,448	22,200				286,648
D.Buxh.e Finan.	110,282	18,450				128,732
D.Sh.Pub.Inf	185,028	323,800	191,700	100,000	90,000	973,528
D.Infrastr.Publi	50,058	47,000			5,881,656	5,115,714
Z.Kom. dhe Kthi.	9,842	730				10,572
D.Bujq.zh.rural	92,297	30,400		70,000		192,697
D.Gjeod.kad.	96,440	10,150				106,590
D.Plan.Urban	52,913	66,150			15,000	154,063
D.Zhvill ekon.	45,173	42,580		50,000		137,753
D.Kultur Rini s	95,437	125,785		135,000	25,000	671,222
Admin Shendet	48,459	8,140		30,000		86,599
QKMF	1,966,840	672,075	54,000		150,822	2,863,737
QPS	109,530	40,380	9,200			449,110
Adm.Arsim	93,508	440,000		100,000	210,000	1,003,508
Arsimi parafillor	207,075	47,000	6,549			260,624
Arsimi fillor	5,634,747	368,166	65,000			6,067,913
Arsimi i Mesëm	1,487,038	126,606	22,000			1,635,644
Gjithsej	11,043,631	2,711,434	348,449	493,000	6,372,478	20,968,992

Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2025


Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunal e	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Zyra kryetarit	173,266	63,000		9,000		245,266
D.Administrat	247,424	153,700				401,124
D.Inspekcionit	76,299	52,700				128,999
Zyra e Kuvend	265,770	22,200				287,970
D.Buxh.e Fin	110,826	18,450				129,276
D.Sh.Pub.In	194,280	319,700	191,700	100,000	70,000	958,680
D.Infrastr.Pub	50,309	35,000			6,816,031	6,030,323
Z.Kom. kth	9,890	580				10,470
D.Bujq.zh.rur	92,857	30,400		75,000		198,257
D.Gjeod.kad.	96,440	10,150				106,590
D.Plan.Urban	53,177	76,150			15,000	164,327
D.Zhvill ekon	45,399	42,510		60,000		147,909
D.Kultur Rini	96,487	117,175		135,000	25,000	673,662
Admin Shend	48,623	3,840		30,000		82,463
QKMF	1,977,422	661,663	73,905		294,134	3,007,124
QPS	115,032	40,380	9,200			394,612
Adm.Arsim	93,975	441,751		100,000	170,000	1,043,743
Arsimi paraf	208,110	48,215	6,549			262,874
Arsimi fillor	5,662,921	367,823	65,000			6,095,744
Arsimi i Mesem	1,494,473	170,000	22,000			1,686,473
Gjithsej shpenz.	11,112,980	2,675,387	368,354	509,000	7,390,165	22,055,886

Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2026

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Z.Kryetarit	174,132	65,400		9,000		248,532
D.Administrate	248,661	151,700				400,361
D.Inspekcionit	76,680	52,850				129,530
Zyra Kuvendit	267,099	22,200				289,299
D.Buxh.financa	111,372	18,450				129,822
D.sh.Pub I.Rru	203,994	346,100	191,700	100,000	60,000	984,794
D.Inf.Publike	50,560	31,000			7,676,592	6,781,560
Z.Kom.Kthim	9,915	600				10,515

D.Bujq.zh.rur	92,857	13,000		80,000		185,857
D.Gj.Kad	96,440	10,150				106,590
D.Planif Urban	53,443	76,150			15,000	164,593
D.Zhv.Ekonomi	45,626	42,810		70,000		158,436
D.Kult.R.Spor	96,949	117,175		135,000	24,000	673,124
D.Ad.Shendet	48,812	3,840		34,000		86,652
QKMF	1,996,896	721,663	81,029		355,991	3,155,579
QPS	119,417	40,380	9,200		200,000	368,997
Adm.Ars	94,445	444,651		100,000	80,000	1,092,688
Arsimi Parafill	209,151	48,215	6,549			263,915
Arsimi Fillor	5,691,236	378,433	65,000			6,134,669
Arsimi Mesëm	1,501,945	251,008	22,000			1,774,953
Gjithsej. shpenzime	11,189,630	2,835,775	375,478	528,000	8,211,583	23,140,465

Tabelat e lartshënuara, paraqesin planifikimin e shpenzimeve sipas karakterit ekonomik dhe funksional për vitet 2024-2026, bazuar në kërkesat fillestare të mbajtësve të buxheteve komunale (drejtoratet dhe zyrat komunale). Vlerësimet e përgjithshme për kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve janë si më poshtë:



3.3.1 Pagat dhe Mëditjet – Pagat dhe shtesat: Ligji pagave për sektorin publik është aprovuar ne Kuvendin e Kosovës dhe i publikuar në gazetën zyrtare me dt.05.01.2023 dhe si i tillë ka filluar aplikimin nga muaji Shkurt i vitit 2023. Për kalkulimin e pagave për vitin 2024 është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2023 dhe për punëtorët aktual është llogaritur shumëzuar me 12 muaj. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm 30%, brenda kufizimeve buxhetore.

Kjo kategori e shpenzimeve mund t'i nënshtrohet ndryshimit për organizata buxhetore varësisht prej zbatimit të procesit të ekuivalencës.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet.- Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

3.3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2023.

3.3.4 Subvencionet dhe transferet: Subvencionet dhe transferet, pritet të rriten mesatarisht me rreth 3.7%. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

3.3.5 Investimet Kapitale - përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 23.9% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve.

3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8:

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%	Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2024 (31 dhjetor 2026)	%
Gra	13,516	23.12	15,240	23.13
Burra	13,956	23.88	15,742	23.86
Vajza	15,242	26.01	17,145	26.07
Djem	15,737	26.99	17,792	26.92
Popullata e përgjithshme	58,451	100.00	65,919	100.00

Meqenëse deri më tani është punuar në projekte kapitale të infrastrukturës, ndarja buxhetore nuk ka mund të bëhet sipas barazisë gjinore. Komuna në të ardhmen do të mundohet që të bëjë planifikimin e investimeve kapitale në proporcion të barazisë gjinore. Me zvogëlimin e numrit të projekteve në infrastrukturë, do të mbesin mjete për projekte tjera dhe do të merret parasysh më për së afërmi barazimi gjinor gjatë shqyrtimit të projekteve të ndryshme. Komuna tani për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor ka një analizë, e cila do të shërbejë si bazë për ndarjen buxhetore sipas barazisë gjinore. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave.

V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

ZYRA E KRYETARIT

Misioni: Bënë mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson komunën , në pajtim me Kryesuesin e Kuvendit konvokon mbledhjet e Kuvendit të komunës, nënshkruan të gjitha aktet e aprovuara nga Kuvendi Komunal, kujdeset për zbatimin e ligjit , rregulloreve dhe Statutit të komunës, bënë propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të komunës. Kjo zyre ka gjithsej 19 punëtorë.

Vizioni: Avancimi dhe perfeksionimi i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore. Arritja e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore me një nikoqirllëk dhe duke u bazuar në parimin vlere për paratë. Avancimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha burimeve humane.

Qëllimi: Ngritja e zhvillimit ekonomik. Ngritja e nivelit të mirëqenies sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim . Ofrimi sa më i mirë i të gjitha shërbimeve për qytetarët e komunës. Shndërrimi i administratës në një administratë moderne, sa më funksionale dhe të rregullt. Shfrytëzimi sa më racional dhe ekonomik i të gjitha burimeve njerëzore, financiare dhe materiale që ka komuna në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	19	19	19
2	Numri i shërbimeve			
	Konvokimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me kryesuesin	12	12	12
	Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për politikë dhe financa dhe komitetet tjera	100	100	100
	Përfaqësimi i Komunës brenda dhe Jashtë vendi	15	15	15
	Organizimi i mbledhjeve me publikun dhe përfaqësuesit e komuniteteve			
	Kryerja e auditimeve të rregullta	8	8	8
	Raportimet para Komitetit të Auditimit	8	8	8
	Kryerja e auditimeve të rregullta	8	8	8
	Raportimet para Njesisë Qendrore Harmonizuese	2	2	2
	Bashkëpunimi me ZAP-in	1	1	1
	Bashkëpunimi me mediat e shkruara dhe elektronike	365	365	365
	Redaktimi i faqes zyrtare të informimit të Komunës	200	200	200
	Regrutimet e punonjësve të rinjë	15	15	15
	Trajnimi i punonjësve	70	70	70
	Avancimi i punonjësve	70	70	70
	Raportimi për rrjedhën e detyrave në lidhje me PVPE	10	10	10
	Bashkëpunimi e mbikq. në realiz. e det që dalin nga PVPE	50	50	50
	Përfaqësimi i Komunës në Kontestet gjyqësore	30	30	30
	Gjithsej: kuantitativ	964	964	964

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

ZYRA E KUVENDIT

Misioni: Zbatueshmëria e ligjeve në fuqi, përgatitja e akteve normative në përputhshmëri me ligjin si dhe arkivimin e të gjitha këtyre akteve.

Vizioni: Planifikimi i punëve sipas ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore dhe realizimi i këtyre punëve sipas planifikimit.

Qëllimi: Përgatitja e materialit për kuvend, mbajtja e procesverbaleve dhe nxjerrja e vendimeve të aprovuara nga kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve për MAPL-ë.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarëve	-	-	-
2	Numri i shërbimeve			
	Punët kuantitative në nr. Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit	12	12	12
	Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të KPF	14	14	14
	Pranimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi dhe dërgimi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend	60	60	60
	Mbajtja e procesverbaleve në mbledhjet e KPF-së dhe Kuvendit	26	26	26
	Përgatitja e vendimeve të dala nga Kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve Kryetarit të Komunës dhe MAPL	60	60	60
	Takimet e Komitetit për Komunitete dhe atyre konsultative me Komisionet e Kuvendit Komunal	44	44	44
	Gjithsej	216	216	216

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë me afat, duhet të sigurohen mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ushtron dhe zbaton shërbime të përgjithshme për organet administrative dhe tjera komunale, si dhe ofron shërbime për qytetarët e Komunës së Drenasit në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

Misioni: Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët në afat të shkurtër kohor dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të Bordit të Drejtorëve dhe trupave tjerë punues. Të Siguroj shërbime efektive për qytetarët dhe të siguroj transparencën e shërbimit civil komunal.

Vizioni: Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe cilësore për qytetarët, organet administrative dhe organet tjera komunale. Vizioni dhe qëllimi ynë si drejtorat është të ofrojmë shërbime më të mira komunale, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmes tyre të rrisim shkallën e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet administrative komunale.

Qëllimi: Qëllimet e Drejtorisë së Administratës janë ngritja e performancës komunale, shërbime komunale cilësore për qytetarët dhe organet e saj administrative.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarëve	42	42	42
2	Numri i shërbimeve			

Ekstrakte certifikatash të gjendjes civile	45000	46000	47000
Procedura të prokurimit publik	145	150	155
Vërtetime të ndryshme dhe legalizim dokumentesh	691	695	700
Gjithsej:	45,836	46,845	47,855

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2023-2025 do të kryhen me cilësi, nëse lejohet buxheti i kërkuar më lartë, në të kundërtën do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

DREJTORATI PËR INSPEKSION

Misioni: Menaxhimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrave programore të inspektorëve në kuadër të drejtoratit, hartimi i planeve ditore dhe javore në zbatimin e programeve të punës në të gjitha lëmit inspektuese.

Vizioni: Sigurimi i të gjitha procedurave, udhëzimeve dhe politikave për inspektimin sa më të mirë të aktiviteteve të këtij Drejtorati.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i Drejtoratit të Inspeksionit është mbikëqyrja e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje ndërtimi dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje ndërtimi, inspektimi lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve ekonomike me certifikata të biznesit, si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. Po ashtu qëllimi i këtij drejtorati është mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit të produkteve të ambalazuara dhe të pa ambalazuara, ujit të pijes, pastërtisë së qytetit, tregjeve, rrugëve, trotuareve si dhe inspektimi i ujërave të zeza etj. Qëllim tjetër është mbikëqyrja e kompanive transportuese në komunikacionin rrugor, orari i udhëtimit, inspektimet në lëmin e bujqësisë farërat, plehrat, të mbjellat pranverore e vjeshtore etj.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	10	10	10
2	Numri i shërbimeve: Kuantitative			
	Kontrollime	2050	2200	2300
	Procesverbale	1300	1550	1800
	Pëlqime	150	160	180
	Gjithsej kuantitative:	3500	3910	4280
3	Numri i shërbimeve: Kualitative			
	Aktvendime	300	330	350
	Fletëparaqitja	120	150	160
	Konkluzione	80	90	110
	Konfiskim malli	50	60	80
	Gjithsej kualitative:	550	630	700

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2023-2025 do të kryhen me cilësi nëse lejohet buxheti i kërkuar më lartë, në të kundërtën do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

Misioni: Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konform me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të obligimit dhe detyrave që i ka për të kryer.

Vizioni: Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konform me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të implementimit dhe realizimin e politikave fiskale të hartuar nga Qeveria qendrore dhe implementimin e politikave lokale.

Qëllimi: Drejtorati për Buxhet dhe Financa bënë planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit – financave të komunës i siguron programet- nënprogramet (drejtoratet dhe zyrat komunale) me shërbimet e kontabilitetit, duke siguruar raportim ditor, javor , mujor , periodik dhe përfundimtar lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal si dhe informon lidhshpënjëshmërisht komunal me aktualitetet e ndërlydhura me buxhetin- financat e komunës.

12	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
12	Numri i të punësuarve	16	16	16
2	Numri i shërbimeve			
	Zhvillimi i aktiviteteve për planifikimin e buxhetit 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,	1	1	1
	Përgatitja e Kornizës afatmesme Buxhetore 2024-2026	1	1	1
	Vërtetime për pasuri për qytetar lidhur me rregullimin e dokumentacionit	20,230	20,330	20,550
	Aprovimi i pagesave	4,184	4,195	4,230
	Zotime për ekzekutim pagesave	4,184	4,195	4,230
	Shpenzime	4,119	4,125	4,130
	Lëshimi i faturave sipas kërkesave të palëve	11,240	11,300	11,350
	Objekte të reja të matura dhe rimatura	2,620	2,630	2,750
	Numri i ankesave dhe kërkesave për korrigjim	660	665	670
	Kërkesa për regjistrimin e objekteve të reja	203	210	230
	Anketim i tatimpaguesve	2,550	2,650	2,700
	Modifikim i të dhënave të pronës	17,350	17,400	17,450
	Modifikim i të dhënave të tatimpaguesve	11,119	11,125	11,130
	Vërejtjet e fundit	900	920	930
	Raporte të barazimit tre mujor	4	4	4
	Raporte financiare tre mujore	4	4	4
	Raporte pune gjashtëmujore	2	2	2
	Raporti vjetor dhe Pasqyrat vjetore financiare	1	1	1
	Pagesa arke piti cash	5	5	5
	Gjithsej:	79,377	79,763	80,368

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë me afat, performancë të lartë dhe të bazuara në ligje dhe dispozita ligjore në fuqi, duhet të sigurohen mjete financiare sipas kërkesave për kategori ekonomike të shpenzimeve.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Misioni: Raporton rregullisht Kryetarin e Komunës për punën e Zyrës, i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës raport vjetor, paraqet raport në çdo takim të Komitetit për Komunitete ,

informon dhe raporton tek institucionet e Qeverisë Qendrore lidhur me aktivitetet e Zyrës, i propozon Kryetarit të Komunës një buxhet vjetor për të siguruar një funksionim të duhur të Zyrës dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kompetencave të veta, merr pjesë në mbledhjet e Drejtorëve të Komunës, bashkëpunon ngushtë me institucionet e Qeverisë qendrore dhe me organizatat e tjera vendore e ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të Komuniteteve, Kthim dhe Riintegrim.

Vizioni: Të kontribuon drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta.

Qëllimi: Të këshilloj autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	1	1	1
2	Numri i shërbimeve			
	Vizita tek personat e riatdhesuar	80	100	120
	Vizita tek komunitetet pakicë	6	6	6
	Shqyrtimi i kërkesave të tyre	90	90	80
	Mbledhjet me Komitetin për Komunitete	6	6	6
	Mbledhjet me Komisionin Komunal për Riintegrim	12	12	12
	Takimet me Institucionet e Qeverisë së Kosovës	20	20	18
	Takimet me organizata lokale dhe ndërkombëtare	16	16	14
	Gjithsej:	230	250	256

Për realizimin e shërbimeve të planifikuara më lartë kërkohet miratimi i buxhetit të planifikuar me kërkesa buxhetore.

DREJTORATI PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Misioni: Misioni i Drejtoratit për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës, duke përfshirë : Përgatitë dhe zbaton politika të cilat nxisin zhvillimin e Komunës, mundësojnë zhvillimin e bizneseve bujqësore intensive, zhvillimin e bujqësisë përmes përmirësimit të kushteve infrastrukturore, ngritjen e kapaciteteve të fermerëve për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe mbështetjen sektoriale në krijimin e ambienteve të volitshme, përkrahjen e investitorëve vendor dhe të jashtëm për një synim të qëndrueshëm të bujqësisë dhe punësimit .

Vizioni: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural është përcaktuar të forcoj sektorin e bujqësisë në të gjitha lëmitë e agrobizneseve, të bëjë të mundshme programet e qëndrueshme bujqësore. Krijimi i një sistemi sektorial bujqësor intensiv dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Qëllimi: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural ka për qëllim të krijoj një sistem sektorial të bujqësisë intensive në rritjen e prodhimitarisë bujqësore dhe të cilësisë për një konkurrencë të denjë në tregun vendor dhe rajonal si dhe mbështetjen e agrobizneseve, fermerëve të vogël, të mesëm dhe të mëdhenj përmes granteve dhe subvencioneve, sektorializimin dhe zbatimin e kriterëve në dhënien e subvencioneve për fermerët, përkrahjen e zhvillimit të agrobizneseve duke synuar nxitjen e ndërtimit të identitetit dhe brendeve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	14	14	14

2	Numri i shërbimeve			
	Zhvillimi i aktiviteteve për planifikimin e buxhetit 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,	1	1	1
	Përgatitja e Kornizës afatmesme Buxhetore 2024-2026	1	1	1
	Kërkesat e ndryshme për përkrahje në bujqësi	350	370	440
	Mbështetja e infrastrukturës në projektin e sistemit të ujitjes	200	210	230
	Subvencionimi në Sektorin e Blegtorisë	180	220	250
	Subvencionimi në Sektorin e Lavërtarisë	550	590	610
	Subvencionimi në Sektorin e Pemëtarisë	130	140	150
	Subvencionimi në Sektorin e Perimtarisë (Prodhimtarisë Bimore)	120	130	140
	Lëndët për subvencionimin në grurë, misër, pemë, perime, blegtori etj.	1200	1250	1350
	Ngritja e kapaciteteve trajnuese në bujqësi	300	350	360
	Krijimi dhe fuqizimi i shoqatave në sektorët e bujqësisë	1	2	4
	Mbështetja e sektorit të BMA-së	30	40	45
	Mbrojtja e pyjeve dhe numri i fletëparaqitjeve	40	35	30
	Trajtimi i pyjeve me veprime silvikulturore teknike – rrallime	20	30	35
	Pyllëzimet në sektorin publiko - privat	15	20	25
	Krasitja e halorëve të reja të pyllëzuara pas lufte	10	15	20
	Gjithsej	3148	3404	3691

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë më sukses kërkohet miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Misioni: Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është bartëse e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Hartave Zonale dhe Planeve Rregullative Urbane të Hollësishme, bënë implementimin e tyre dhe lëshon lejet e ndërtimit, kujdeset për dokumentacionin investivo-teknik dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e dhëna urbano-teknike, lejon shfrytëzimin e hapësirave publike, mbulon sferën e banimit, bashkëpunimin e ngushtë me nivelin qendror përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA).

Vizioni: Komunë me zhvillim të balancuar, planifikim të qëndrueshëm urban, banim cilësor, mjedis të pastër.

Qëllimi: Në sektorin e planifikimit qëllimi kryesor është angazhimi në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm të qytetit dhe trajtimin e kërkesave brenda afatit ligjor, dhënia e kushteve të ndërtimit dhe leje të ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane. Ndërsa në Sektorin për Mbrojtje të Mjedisit është monitorimi në zhvillimin dhe zbatimin e dokumentacionit në fushën e mbrojtjes së mjedisit në trajtimin e menaxhimit e mbeturinave, ruajtjen e cilësisë së ajrit, mbrojtja nga zhurma, mbrojtja e natyrës të cilat kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarëve	8	8	8

2	Numri i shërbimeve			
	Lejet mjedisore komunale (LMK)	15	15	15
	Leje të ndërtimit	30	35	40
	Leje rrërimi	15	20	25
	Certifikata e Përdorimit	10	15	25
	Legalizimi i objekteve	740	0	0
	Çështjet banesore	5	7	10
	Vendosja e numr. të objekteve e tabelave për emërim të rrugë.	1000	1500	2000
	Lejet për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike	15	15	15
	Hartimi dhe Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028	1	0	0
	Hartimi dhe Miratimi i Hartës Zonale të Komunës 2020-2028	1	0	0
	Gjithsej:	1,832	2,344	2,867

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me sukses, kërkohet miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve

DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS

Misioni: I Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë është të sigurojë një shërbim cilësor dhe të efektshëm nëpërmjet organizimit dhe koordinimit të shërbimeve publike dhe menaxhimit të emergjencave në komunën tonë.

Vizioni: Vizioni i këtij Drejtorati është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës , Ligjin për Qeverisje Lokale, dhe planin e punës së DSHPE-së, dhe të jemi një model i përkryer në ofrimin e shërbimeve publike, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës së qytetarëve tanë.

Qëllimi: Është që të ngris standardin në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimeve publike, duke i realizuar të gjitha projektet e mirëmbajtjes që përfshinë: Mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara dhe të rendit të – IV, trotuareve, mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik, menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësin për ujë të pijes, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra, Shërbimi i transportit publik me autobus dhe autotaxi, mirëmbajtjen e parkingjeve, mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës së verës dhe dimrit, shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve, mirëmbajtjen e sistemit të kamerave, menaxhimin dhe trajtimin e rasteve emergjente që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shërbimin e varrimit për qytetarë etj.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarëve	25	25	25
2	Numri i shërbimeve			
	Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit	3 Ha	3 Ha	3 Ha
	Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Drenasit/m ²	1,500 m ²	2,000 m ²	2,000 m ²
	Shenjëzimit Vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve/copë	210 copë	230 copë	250 copë

Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në komunën e Drenasit/Lokacione	4	5	5
Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gr. Septike/km'	45 km'	60 km'	75 km'
Zgjerimi dhe Mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit/ copë	10 copë	13 copë	15 copë
Eliminimi i deponive ilegale/ ton	6500 t	5300 t	4500 t
Zgjerimi dhe Riparimi i rrjetit të Ndriçimit Publik në komunën e Drenasi/km'	51 km'	71 km'	89 km'
Rregullimi dhe rehabilitimi i tregjeve/lokacione	1	1	1
Mirëmbajtja e Deponisë inerte/ lokacion	1	1	1
Rregullimi e trotuareve dhe parkingjeve/m ²	250 m ²	500 m ²	750 m ²
Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi I tyre	2	4	4
Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të SHZSH-së në Gllobar	1	1	1
Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina	1	1	1
Mirëmbajtja e rrugëve gjatë dimrit/ km	512.5 km	512.5 km	512.5 km
Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës/ m ²	103,968m ²	103,968m ²	103,968m ²
Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavorr/m ³	1,200 m ³	1,200 m ³	950 m ³
Trajtimi i qenve endacak/copë	500 copë	500 copë	500 copë

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me sukses, kërkohet miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR KADASTER, GJEODEZI DHE PRONË

Misioni: Drejtorati për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë, është që të siguroi menaxhimin e përgjithshëm të drejtë dhe transparent të mirëmbajtjes së pronës së paluajtshme publike dhe private në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit, konform ligjeve në fuqi.

Vizioni: Vizioni i këtij drejtorati është që të jetë sa më transparent në trajtimin, regjistrimin dhe mbrojtjen e pronës komunale. Si dhe ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodezike dhe të pronësisë për qytetarët e Komunës së Drenasit, në mënyrë sa më efikase, të shpejt dhe transparente.

Qëllimi: DKGJP ka për qëllim ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodete dhe të pronësisë për qytetarët e Komunës së Drenasit, në mënyrë sa më efikase, të shpejt dhe transparente, në realizimin e kërkesave për ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e pronave, kërkesave për pajisje me kopje të planeve dhe fletë-posedueseve e shërbimeve të tjera.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	13	13	13
2	Numri i shërbimeve			
	Fletë poseduese	2750	2810	2870
	Kopje plani	720	750	787
	Aktvendime mbi regjistrimin e pronës	470	540	610
	Aktvendime mbi hipotekën	36	37	41

Vendime për shpronësime	3	4	5
Certifikata mbi gjendjen ekonomike	1490	1520	1562
Aktvendime mbi marrjen e pronës së uzurpuar	50	90	120
Konstatimi i gjendjes faktike në teren	40	50	67
Kërkesa zyrtare për teren	120	130	144
Kërkesa për koordinata	110	130	145
Kërkesa për bashkim të parcelave	78	87	95
Kërkesa për ndarje të parcelave	470	540	670
Gjithsej:	6302	6688	7119

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Misioni: DKR organizon, menaxhon dhe koordinon veprimtaritë kulturore, aktivitetet sportive dhe rinore. Koordinon punën e këtyre aktiviteteve me komunat tjera, asociacionet, shoqatat dhe organizatat që merren më këtë veprimtari. Kujdeset për trashëgimin kulturore dhe për gjithë infrastrukturën ku zhvillohen aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive si dhe bibliotekat.

Vizioni: Planifikon, harton dhe mbikëqyrë realizimin e plan-programit vjetor të punës së sektorëve menaxhon stafin, objektet dhe buxhetin e DKRS.

Qëllimi: Arritja e rezultateve sa më të mira në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, begatimi i bibliotekave me literaturë dhe krijimi i kushteve sa më të favorshme për punën e Arkivit komunal historik.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	13	13	13
2	Numri i shërbimeve			
	Sofra poetike “Ymer Elshani”	1	1	1
	Programe artistik për festa kombëtare dhe shtetërore	5	5	5
	Manifestimi ditët e humorit Drenasi	1	1	1
	Shënimi i muajit Rinor dhe aktivitete me “Handikos”	3	3	3
	Gara sportive në nivelin komunal, turnirë memorialë dhe tradicionale	6	6	6
	Gjithsej:	16	16	16

Për t’i realizuar punët e planifikuara më lartë me sukses, kërkohet miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Misioni: Misioni i Shëndetësisë është që të zhvillojë dhe të sigurojë sistem efektiv dhe efikas të mbrojtjes shëndetësore kualitative, që t’i plotëson nevojat e popullsisë pa dallim nga origjina etnike, religjioni, mosha dhe gjinia, në përmirësimin e statusit të përgjithshëm shëndetësor.

Vizioni: Sigurimi i shëndetit më të mirë për të gjithë banorët e Kosovës, përmes një sistemi shëndetësor efikas brenda burimeve të disponueshme.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i sektorit të Shëndetësisë është të kujdeset për kujdesin parësor shëndetësor të qytetarëve të komunës dhe të kujdeset për përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm publik.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	200	200	200
2	Numri i shërbimeve	Sasia	Sasia	Sasia
	Vizita mjekësore	185000	190000	200000
	Vizita mjekësore shtëpiake	1000	1100	1200
	Vizita stomatologjike	5500	5600	5700
	Vizita konsultative-specialistike	10500	10600	10700
	Vizita gjinekologjike	4500	5000	5500
	Vizita shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri 3 vjet	4450	4500	4600
	Shërbime stomatologjike	6000	6500	7000
	Shërbime laboratorike	14000	15000	16000
	Shërbime rentgeni	14000	15000	16000
	Shërbime të ndryshme (dhënie injeksioneve etj.)	170000	180000	190000
	Vaksinimi i fëmijëve në teren	5800	5900	6000
	Edukimi i vazhdueshëm profesional (mjekëve teknik)	30	30	30
	Edukimi shëndetësor i popullatës në teren	26	26	26
	Bartja e pacientëve në QKUK	1070	1100	1200
	Bartja e pacientëve në Hemo-dializë	38	38	38
	Gjithsej:	421,914	440,394	463,994

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë, me afat, kualitet dhe të bazuara në ligje dhe dispozita ligjore në fuqi, kërkohet miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR ARSIM

Misioni: Që të siguroi menaxhim të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike, po ashtu do të luaj rrol kyç në përcaktimin dhe implementimin e politikave edukative –arsimore dhe zhvillimore të arsimit që rrjedhin nga Programet e MASHT-it në Komunën e Drenasit. Zhvillimin e një procesi arsimor cilësor dhe efektiv që do t'i kontribuojë ngritjes së mirëqenies së shoqërisë, duke ofruar edukim dhe arsim cilësor, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët si dhe cilësi të lartë në fushën e edukimit dhe arsimit në nivel parafillor, fillor dhe të mesëm në pajtim me standardet bashkëkohore.

Vizioni: Përmirësimi i standardit të arsimit për të gjithë nxënësit dhe punonjësit e Arsimit, duke filluar nga institucionet parafillore e deri të Arsimit të mesëm, përmes përkrahjes me investime, zhvillim ekonomik dhe financa të qëndrueshme.

Qëllimi: Drejtorati për Administratë të Arsimit bënë planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të programit të Arsimit e që ky program është i organizuar në katër nivele/nënprograme: 1) Administrata e Arsimit, 2)Arsimi Parafillor & Çerdhet, 3)Arsimi Fillor dhe 4)Arsimi i Mesëm. Ky drejtorat siguron programet/nënprogramet-drejtoratet e shkollave me Udhëzimet Administrative, Rregullore dhe legjislationet e MASHT-it dhe monitoron zbatimin e këtyre dokumenteve ligjore, pastaj siguron shërbimet e kontabilitetit, duke dhënë raportim ditor, javor. Mujor, periodik dhe përfundimtar, lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal, si dhe informon drejtoret e shkollave të

Komunës së Drenasit me aktualitetet e ndërlidhura me çështjet edukativo-arsimore, si dhe me buxhetin-financat e komunës, përkatësisht të shkollave.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	948	948	948
2	Numri i shërbimeve			
	Numri i lëndëve të zotuara	1770	1780	1790
	Kontrata të hartuara	570	530	520
	Shpallja e konkurseve	32	34	30
	Shërbimet lidhur me regjistrimin e nxënësve	1753	1813	1873
	Shërbimet lidhur me nënalokimin e buxhetit	1770	1780	1790
	Shërbimet lidhur me përvojën e punës	920	928	930
	Gjithësej:	6815	6865	6933

Për t'i kryer punët e lartshënuara me kualitet dhe sipas dispozitave ligjore, kërkohet aprovimi i kërkesave buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Misioni:DZHE përgatit dhe zbaton politika të cilat nxisin zhvillimin ekonomik të komunës, mundësojnë zhvillimin e bizneseve, krijimin e një ambienti të volitshëm për joshjen e investitorëve vendor, diasporës, investitorëve të jashtëm që synon zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe punësim.

Vizioni:DZHE është përcaktuar ta forcoj sektorin privat në të gjitha lëmitë ekonomike, partneritet publiko-privat, krijimin e zonave të qëndrueshme për investitor të mundshëm në programe të qëndrueshme ekonomike.

Qëllimi:DZHE ka për qëllim ta krijoj një sistem sektorial, rritjen e prodhimtarisë dhe cilësisë për një konkurrencë të denjë në tregun vendor dhe rajonal si dhe mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, mbështetjen përmes granteve të ndërmarrësve të rinj.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	7	7	7
2	Numri i shërbimeve			
	Aktvendimi të Taksës Komunale për leje operative	600	620	650
	Regjistrimi i bizneseve të reja	225	230	253
	Ndryshimet në biznes	150	180	210
	Shuarjet e bizneseve	35	40	45
	Certifikata të reja nga UNMIK në Rep. e Kosovës	50	60	60
	Vërtetime të Taksës Komunale	35	40	50
	Hartimi i planeve për nxitjen e investitorëve të jashtëm	35	42	53
	Ofrimi i sesioneve inform. për grandet për biznese nga minist.	4	6	8
	Koordinimi i projekt.me partneritet publiko-privat	27	29	32
	Bashkëp.me insti. ndërkom. për projekte të ndrysh.	20	25	30
	Komunikimi i vazhd.me diasporën i lidh.me biz.	15	20	25
	Promovimi i turizmit	42	44	45
	Gjithsej:	1,250	1,348	1,473

Ky drejtorat, kërkon aprovimin e kërkesave buxhetore pa shkurtime me qëllim të kryerjes së shërbimeve të synuara.

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Misioni: Misioni i këtij Drejtorati është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara më Statutin e Komunës, duke përfshirë këtu: Projektet Kapitale si ndërtimi i rrugëve, ujësjellesit, kanalizimit, ndriçimit publik etj.

Vizioni: Vizioni i Drejtoratit të Infrastrukturës është që çdoherë të jetë e gatshme në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duke ofruar standarde sa më cilësore në realizimin e projekteve kapitale.

Qëllimi: Është që të realizoj të gjitha projektet kapitale të cilat dalin si rezultat i planifikimit të infrastrukturës komunale si dhe të ngritet cilësia dhe standardi për të gjitha punët e kryera. Ky Drejtorat do të kryej punë dhe detyra si më poshtë: Asfaltimi i rrugëve, Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për të gjitha vendbanimet në të cilat mungon, Ndërtimi i rrjetit të kolektorëve dhe kanalizimit të ujërave të zeza, Ndërtimi i kanalizimit atmosferik, Ndërtimi i Trotuareve, Ndërtimi i ndriçimit publik, Ndërtimi i Ujërave, Parqeve dhe Shesheve, si dhe projekteve tjera infrastrukturore.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2024	2025	2026
1	Numri i të punësuarve	8	8	8
2	Numri i shërbimeve			
	Mbikëqyrja e projekteve kapitale	270	290	320
	Pranimi i punimeve në terren	112	120	135
	Gjithsej:	382	410	455

Për t'i kryer me sukses punët dhe detyrat e punës, ky program buxhetor kërkon aprovimin e buxhetit të kërkuar.

Lista e projekteve kapitale është pjesë përbërëse e kësaj Kornize, e plotësuar gjatë fazave të planifikimit dhe e aprovuar në Kuvendin e Komunës. Projektet janë të bazuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Komunal dhe të mbuluara me masë të mjaftueshme financiare, nga Granti i Përgjithshëm dhe të Hyrat Vetanake.

Drenas, më _____



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci